



## DREJTORIA E PROJEKTEVE DHE ZHVILLIMIT

### SEKTORI COST

### FINANCIMI

Nëpërmjet financimit të këtyre projekteve synohet lidhje më e mirë e kërkuesve që punojnë në fusha të ngjashme, por edhe në fusha të ndryshme në rrjete ku ato mund të komunikojnë dhe rrisin efektivitetin e kërkimit.

Në këto projekte financohet:

- **Pjesëmarrja në rrjet** ([komiteti menaxhues MC](#) dhe grupet e punës WG), seminare;
- **Misionet shkencore afatshkurtra (STSM)**: vizita shkëmbimi për studiuesit deri në gjashtë muaj në një institucion ose laborator me bazë në një vend tjetër, i cili është gjithashtu pjesë e CA;
- **Shkolla trajnimi**: organizohet nga çdo COST Action për një temë të zgjedhur prej tyre dhe mbahet në ambientet e një institucioni ose organizate pjesëmarrëse, zgjasin deri në 15 ditë);
- **Grantet e konferencës**: u drejtohen studiuesve të rinj dhe studentëve të doktoraturës nga vendet e synuara gjithëpërfshirëse;
- **Granti i Inovatorëve COST**: kanë të drejtë të aplikohen me ftesë nga Shoqata COST, kanë një kohëzgjatje prej 12 muajsh dhe përfitojnë nga të njëjtat aktivitete rrjetëzimi të disponueshme për Aksionet COST;
- **Komunikimi dhe shpërndarja**: ndarja e rezultateve shkencore me studiuesit, politikëbërësit, sektorin privat dhe shoqërinë civile si OJQ-të.
- **Mjetet e rrjeteve virtuale**: dy lloje të reja grantesh për t'iu përgjigjur nevojës në rritje të mjeteve dixhitale në kontekstin e pandemisë dhe për të siguruar vazhdimësinë e aktiviteteve të punës së COST Actions: Mbështetja e rrjeteve virtuale (VNS) dhe Lëvizshmëria virtuale (VM)



Funded by  
the European Union